



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:104996

Datë: 04.03.2021

Numri i dokumentit: 01621076

C.nr.991/18

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditësve K.F., L. F.dhe i mituri J. F.të cilin e përfaqëson përfaqësuesja ligjore- nëna L. F.nga Ferizaj, ndërsa të gjithë me autorizim i përfaqëson av.Avni Leci nga Prishtina, rr "Idriz Gjilani"nr.11, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim av. Veton Robaj nga Prishtina, në çështjen juridike kompensim i dëmit material dhe jo material, në seancën kryesore të mbajtur me dt.09.02.2021 në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse mori, ndërsa më datë 4 mars 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve K.F., L. F.dhe i mituri J. F.të cilin e përfaqëson përfaqësuesja ligjore- nëna L. F.nga Ferizaj, si e bazuar.

II.DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të dëmshpërblimit të demit jo material dhe material, sipas përgjegjësisë së ndarë 70% - 30% në favor të palëve paditëse, t'ia paguaj paditësve shumën e përgjithshme prej 40,685.17€ dhe rentën mujoren nga data 01.12.2020 për paditësit L. F. dhe J. F., siç viJ. F.:

a) Në emër të dëmit jo material

Në emër të përjetimit të dhimbjeve shpirtërore, për vdekjen e djalit, bashkëshortit dhe babait të tyre D. F.siq vijon:

Paditëses K.F.(nënës së të ndjerit shumën prej 7.000 euro për 70% të shumës i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **4.900€**.

Paditëses L. F.(bashkëshortes së të ndjerit) 7.000euro, për 70% shumës i takon të kompensohet nga e paditura **4.900€**.

Të miturit J. F. (djali i të ndjerit D. F.) 8.000 euro për 70% shumës i takon të kompensohet nga e paditura **5.600€**.

b) Në emër të dëmit materiale

Paditëses L. F., në emër të dëmit material në automjetin e markës “Audi Q5” me numër të identifikimit të automjetit, me targë, 18.937 për 70% të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **13.255,90€**.

Në emër të shpenzimeve të varrimit 1.500 euro për 70 % të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **1.050€**.

Në emër të ngritjes së përmendores 1.000 euro për 70% të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **700€**.

Në emër të për rroba- veshmbathje shumën prej **300€**.

Në emër të dëmit material rentës - mbajtjes së humbur, duke filluar nga dita e aksidentit me dt. 15.07.2018 e deri me dt. 30.11.2020, paditëses L. F. dhe të miturit J. F. shumën e arritur për pagesë së bashku me kamatë shumën prej 14.256,11€ për 70% të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **9.979,27€**.

Në emër të dëmit material rentës - mbajtjes së humbur nga dt.01.12.2020 për çdo muaj për paditësen L. F.i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej 153,45 për 70% të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura në shumën prej **107.40€** në muaj;

Në emër të dëmit material rentës - mbajtjes së humbur për të miturin J. F., shumën prej 295,11 për 70% të përgjegjësisë i takon të kompensohet nga e paditura shumën prej **206,60€** në muaj, e gjer sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë.

III. DETYROHET e paditura BKS nga Prishtina, që paditësve në emër të demit material dhe jo material t'ia paguaj shumat e gjykuara si në dispozitivin nr.II të këtij aktgjykimi, të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data 15.10.2018 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 6,008.40 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësit K.F. (nëna e të ndjerit D. F.), L. F.(bashkëshortja e të ndjerit) dhe i mituri J. F.(djali i të ndjerit) që të gjithë nga Ferizaj të cilët i përfaqëson me autorizim av.Avni Leci nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur padi në gjykatë më dt. 15.10.2018 kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, në emër të kompensimit të demit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 15.07.2018. Lidhur me këtë gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 09.02.2021, në të cilën seancë i autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë parashtresës për precizim të kërkesëpadiisë, si dhe nga të gjitha provat e administruara nga gjykata e posaçërisht duke marr për bazë pajtimin gjyqësorë të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.859/18, ka theksuar se për të njëjtën çështje vetëm me palë të ndryshme e paditura është pajtuar që për këtë rast të aksidentit të kompensoje palët e treta nga autopergjegjsia për 70%, ashtu që kërkon nga gjykata që kërkesëpadiinë e paditësve të aprovojë si të bazuar duke e aplikuar në institutin e përgjegjësie së ndarë prej 70%, që i ka siguruar të paditurit ndërsa 30% ka theksuar se ka kontribuar vet i ndjeri D. F. ashtu që për këtë nuk ka kërkuar kompensim. Ndërsa ka deklaruar se sa i përket vëllimit- lartësisë se kërkesëpadiisë i propozojnë gjykatës që të bazohet në arsyetimet e dhëna nga palët paditëse si në precizimin e kërkesë padisë duke e detyruar të paditurën që paditësve të ia kompensoje demin material dhe jo material, nga baza e sigurimit të autopergjegjsise, për 70% të përgjegjësisë shumë prej 70.785,18€ dhe rentën mujore nga dt. 01.12.2020 e tutje nga 314€ për paditësen L. F. dhe J. F. në muaj e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagesë në shumat të cilat ka theksuar se i kanë precizuar në petitumin e precizimit të kërkesëpadiisë me kamate ligjore, në shkalle prej 12%, nga dita e paraqitjes tek e paditura se kërkesës se dt. 17.09.2018 e deri në pagesën definitive duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuara në precizim të padisë dhe mendimin juridik të datës. 01.12.2020, gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që paditësve të i paguajë shpenzimet e

procedurës kontestimore në shumë prej 6158.40€, të specifikuar për secilin shpenzim si në petitum të kërkesëpadisë.

E paditura përmes të autorizuarit të saj në përgjigje në padi dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtojnë precizimin e sa i përket lartësisë pasi që vlerat e kërkuara në këtë precizim kanë tejkaluar të gjitha praktikat gjyqësore për të gjitha kategoritë veç e veç dhe kërkojnë nga gjykata që të i falet besimi ekspertizës së punuar nga eksperti A.B. duke theksuar se i njëjti ishte në gjendje ta mbrojë dhe të shuajë të gjitha dilemat rreth ekspertizës së punuar, ka deklaruar që mos të i falet besimi ekspertizës së dytë të akuaristikës së punuar nga eksperti A.G. pasi që i njëjti nuk arriti ta mbrojë dhe i njëjti ishte bazuar në statistikat të cilat janë duke u praktikuar në Kosovës, pasi të e njëjta në rastin konkret nuk përcaktojnë pagesën mesatare sipas kualifikimit, prandaj në bazë të ekspertizave të komunikacionit ka pranuar përgjegjësinë prej 70%, në këtë aksident dhe shpenzimet e procedurës e njëjta të gjykojë sipas suksesit në procedure prej 70%, gjithashtu i ka kërkuar nga gjykata që të mos zbatohet kamatën prej 12%, pasi që si palë e paditur nuk kanë ra në vonese për mos vlerësim nga ana e tyre, mirëpo e njëjta ka ndodhur për mos plotësim të dokumentacionit shtese e cila është kërkuar që nga procedura administrative me qëllim të sqarimit të bazës juridike të kërkesëpadisë.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse administroi provat: *Raporti i Policisë 2018 CFT-394 DT.15.07.2018, Raporti i Policisë Hetues, Policia e Sigurimit dhe librezat e qarkullimit, Procesverbal mbi dëmtimin e automjetit, dëshmi vdekje për D. F., Deklarate për bashkësinë familjare e dt.20.09.2018, certifikate e lindjes në emër të K.H.dt.07.09.2018, certifikate e martesës dt.07.08.2018, certifikate e lindjes për L. F. dt.20.09.2018, Certifikate e lindjes për J. F. dt.20.09.2018, Kontratë LRP.nr.12253/2018, Qarkullimi bankar në emër të D. F. të lëshuar ngadt.06.09.2018, flete transfere (12cope), përgjigje në padi dt.22.11.2018, ekspertize e komunikacionit shkurt 2018 nga eksperti V.B., ekspertizë e komunikacionit dt.21.10.2019 nga B.L., ekspertizë financiare nga A.B.dt. 15.06.2020, ekspertize mjekësore dt.07.07.2020, ekspertize e makinerisë dt. 16.08.2019 nga Q.A., Ekspertize financiare nga A.G., Raport Psikologjik për L. F. dhe J. F., vërtetim i pa punësisë për L. F., vërtetim nga Shkolla”.....”, kërkesë për zhdëmtim dt.17.09.2018, parashtrere për precizim e kërkesëpadisë, Fotografë, Shkresa penale të bashkangjitura, aktvendim i trashëgimisë nr.4898/2018, si dhe shkresa në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe lidhur me*

punën që i ndjeri D. F. ka bërë në Afganistan, Vërtetim Tatimore dhe pasqyra e trustit, vërtetimi nga QPS që nuk merr ndihme sociale.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të gjykatës, Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e bazuar dhe vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 15.07.2018 në rrugën “Rexhep Bislimi” afër urës në Ferizaj, ka qenë aksident me fatalitet në mes të drejtuesit A.S.i cili kan wnë duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes S500” me targasi dhe Drejtimit – tashmë i ndjeri D. F. duke drejtuar automjetin e markës “Audi Q5”, në të cilin Aksident ka humbur jetën i ndjeri D. F., familjari i paditësve.

Faktin se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 15.07.2018 gjykata e ka vërtetuar nga raporti i aksidentit me nr. 2018-CFT-394 i datës 15.07.2018, fakt ky i cili nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

Se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me fajin e vozitësit A.S., automjetit “Mercedes S500” me targadhe po ashtu ky automjet ishte i siguruar tek e paditura, këto fakte gjykata i vërtetoi nga raporti i aksidentin 2018-CFT-394 e dt.15.07.2018 e po ashtu nga ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti V.B..

Neni 184 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se personat që kanë të drejt shpërblimi në të holla në rast të vdekjeje ose invaliditeti të rëndë ka përcaktuar se “ në rast të vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t’ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhimbjen e tyre shpirtërore.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, duke u bazuar provat e bashkangjitura të cilat janë administruara.

Nga deklarata e bashkësisë familjare e cila është administruar si provë rezulton se paditësit kanë qenë në bashkësi familjare me të ndjerin D. F. .respektivisht paditësija K.F. është nëna e të ndjerit D. F., L. F.bashkëshortja e të ndjerit dhe i mituri J. F.- djali i të ndjerit.

Gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësve dhe atë për dhimbjen shpirtërore për paditësve ia ka njohur shumën e caktuar në dispozitiv II, shumën e aprovuar gjykata e caktoi duke u bazuar në zbatimin e kriterëve të kompanisë, praktikës gjyqësore por edhe në bindjen e lirë të gjykatës, pasi konsideron se shumën e aprovuar e konsideron një shumë e arsyeshme dhe e pranueshme dhe në harmoni me praktikën gjyqësor.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësve për shpenzimet e varrimit shumën prej 1.500 €, duke aplikuar ndarjen e përgjegjësisë për 70% paditësve ju takon të kompensohen nga e paditura për shpenzime të varrimit në shumën prej 1.050 euro, dhe ngritjen e lapidarit në shumë prej 1.000€, duke aplikuar ndarjen e përgjegjësisë për 70% paditësve ju takon të kompensohen nga e paditura për shpenzime të varrimit në shumën prej 700 duke aplikuar ndarjen e përgjegjësisë për 70% paditësve ju takon të kompensohen nga e paditura për shpenzime të varrimit në shumën prej 1.050 euro, si dhe në emër të veshmbathjeve shumën prej 700 euro, ngase vlerësoi se janë shuma të arsyeshme dhe e pranueshme dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

Gjykata konsideron se lartësitë e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo-material dhe material janë një shpërblim i drejtë e të cilat paraqesin një formë të satisfakcionit që paditësit me këto mjete sa do pak do ti lehtësohet dhimbja shpirtërore për anëtarin e familjes së humbur në aksidentin e datës 15.07.2018, e cila shumë nuk paraqitet si shpërblim absolut të dëmit.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material dhe jo material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë e në kuptim të nenit 323 të LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169,172,173,174, 177, 183, 184 dhe 961 të LMD-së, si dhe duke u bazuar nga mendimi i ekspertit i Komunikacionit V.B. si dhe Eksperti i komunikacionit B.L. si dhe ekspertiza nga lëmit aktuaristikës dhe financave nga eksperti A.B., Dr Sh.H. Psikiatër në ekspertizën e përpiluar me shkrim me datë 07.07.2020, Ekspertiza Q.A..

Nga ekspertiza e ekspertit Q.A. për vlerësimin e dëmit në automjet i cili ka konstatuar në bazë të raportit të policisë nr.2018-CFT-394 dt.15.07.2018, ka theksuar se mund të konstatohet se në automjetin AUDI Q5 2.0 TDI me targaështë shkaktuar dëm material në të automjetin

ashtu siç shihen në fotografitë e automjetit të dëmtuar, si dhe bazuar në dokumentacionin që gjendet në lëndë respektivisht fotografitë e automjetit të dëmtuar si dhe procesverbali mbi dëmtimin e automjetit nr.482/18 dt. 08.08.2018 konstatohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me dëm total teknik, eksperti ka konstatuar se vlera e dëmit total është në vlerë prej 18,405€, makina para një viti para ndodhjes së aksidentit ka pasur vlerën prej 22,000€, pas aplikimit të amortizimit fitojmë vlerën prej 19,580.00€ vlerë kjo e njëjtë me vlerën e tregut për automjetin me karakteristika të njëjta Audi Q5 2.0 TDI siç janë paraqitur në fotot e ekspertizës. Eksperti në ekspertizë ka konstatuar se vlera e automjetit në kohën e aksidentit 19,580.00€, ndërsa vlera e pjesës së mbetur 6.0% 1,175.00€, vlera e dëmit total në vlerë prej 18,405.00€, si dhe ka theksuar se për shkak të dëmtimeve, kthimi i automjetit në gjendjen e mëparshme është i pamundur andaj ka konstatuar se automjeti Audi Q5, nga aspekti i sigurisë në komunikacion është dëm total teknik dhe vlera e përgjithshme e kalkuluar në dëm total teknik për automjetin Audi Q5 2.0 Tdi me targanë kohën e ndodhjes së aksidentit korrik 2018 pas zbritjes së pjesëve të mbetura është 18,405€.

Gjykata ekspertizën e punuar nga lëmia e makinerisë ia fali besimin pasi e vlerësoi si ekspertiza profesionale dhe objektive, dhe në bazë të kësaj ekspertize ka obliguar të paditurën që në emër të dëmit material ti paguaj paditësve shumën prej 18.937€, ku nga ndarja e përgjegjësisë prej 70 % e paditura ka për obligim ti kompensoj paditësit në shumën prej 13.255.90€.

Në ekspertizën e Komunikacionit të punuar nga eksperti V.B., i njëjti ka konstatuar se Aksidenti ka ndodhur në rrugën me zonë urbane, shpejtësia e lejuar në atë pjesë është 50km/h, drejtuesi i automjetit Mercedes ka pasur qëllim kthimin majtas ndërsa drejtuesi i automjetit Audi ka pasur qëllim lëvizjen drejt, drejtuesi i automjetit Mercedes gjatë realizimit të kthimit majtas nuk ndalet në shenjë STOP, drejtuesi i automjetit Mercedes në një moment të caktuar ndalohet në shiritin e djathtë të qarkullimit pothuajse në mënyrë tërthore, sipas video incizimit ka konstatuar eksperti se drejtuesi i automjetit Mercedes ka mundur të vërejë prezencën e automjetit Audi në shiritin e tij të qarkullimit përmes tufës së dritave, drejtuesi i automjetit Audi ka lëvizur me shpejtësi prej 108.8km/h(shpejtësia në momentin e kontaktit me automjetin Mercedes) në momentin e paraqitjes së rrezikut, drejtuesi i automjetit Audi realizon një shmangie të lehtë drejt skajit të jashtëm të shiritit të qarkullimit, me tutje ka konstatuar se deri të aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit Mercedes – mos ndalje në shenjë për ndalim të detyrueshëm STOP gjate kyçjes me kthim majtas, reagim

joadekuat në paraqitje të rrezikut- ndalje në shiritin e qarkullimit dhe lëshimeve sekondare nga drejtuesi i automjetit Audi, mospërshtatje e shpejtësisë së lëvizjes kufizim në atë pjesë të rrugës.

Eksperti V.B. në seancën e datës 18.09.2019 ka mbetura pranë ekspertizës së datës 21.02.2019 dhe ka sqaruar se të dy automjetet kanë pasur lëshime në komunikacion mirëpo aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit Mercedes dhe atë : mos ndalje në shenjën për ndalim të detyrueshëm STOP gjatë kyçjes me kthim majtas, dhe reagim joadekuat në paraqitje të rrezikut- ndalje në shiritin e qarkullimit, dhe lëshimeve sekondare nga mospërshtatja e shpejtësisë së lëvizjes kufizim në atë pjesë të rrugës.

E paditura nuk është pajtuar me ekspertizën e punuar nga V.B., andaj kanë propozuar ekspertizë të re, dhe gjykata ka caktuar ekspertin B.L. i cili në ekspertizën e tij i ka cekur kushtet e motit, gjurmët në vendin e ngjarjes, rrjedha e ngjarjes si dhe pasojat e aksidentit, kontakti në mes të automjete, shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve, mënyrën e lëvizjes së pjesëmarrësve në këtë aksident, dhe mundësinë teknike të evitimit të aksidentit, i cili ka konstatuar se ka ardhur në përfundim se aksidenti rrugor ka ndodhur me datë 15.07.2018 rreth orës 04:20 min në rrugën Ferizaj-Gjilan, saktësisht tek ura që lidh këtë rrugë me rrugën nacionale Prishtinë-Shkup. Vendi në të cilën ka ndodhur ky aksident është udhëkryq i formës “T” i pajisur me sinjalizim horizontal dhe vertikal, në kohën e ndodhjes së aksidentit ka qenë nate (dukshmëria e zvogëluar), moti i mirë, sipërfaqja e rrugës e thatë, gjerësia e rrugës 6.60 metra. Kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes : 50km/h, deri tek ky aksident i komunikacionit rrugës ka ardhur përderisa shoferi me automjetin “A” ishte duke lëviz në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup. Me të arritur në Ferizaj (përballë Restorant Dani) i njëjti duke mos respektuar shenjën “STOP” tenton të kyçet me automjet në rrugën Ferizaj-Gjilan (në drejtim të Gjilanit) në ato momente nga Gjilani në drejtim të Ferizajt ishte duke lëviz shoferi me automjetin B(Audi) i cili me pjesën e përparme përplasat në automjetin “A” (Mercedes) duke shkaktuar aksident Komunikacioni, si pasojë e këtij aksidenti, përpos dëmeve të konsiderueshme materiale të shkaktuar në të dy automjetet, lëndime – me pasoja vdekje-prerëse ka pësuar shoferi i automjetit B, ndërsa lëndime trupore ka pësuar pasagjeri i automjetit B, si dhe një pasagjer tjetër që ndodhej në automjetin A në momentin e aksidentit, deri te kontakti ndërmjet dy automjeteve ka ardhur në shiritin e djathtë të rrugës Gjilan-Ferizaj (nëpër të cilin shirit ishte duke lëviz shoferi me automjetin B para aksidentit) ndërsa deri te goditja në mes të dy automjeteve vie me pjesën e përparme (frontale) të automjetit B(Audi) në pjesën anësore të përparme të majtë të automjetit A(Mercedes), shpejtësia e automjetit B(Audi) në momentin e

përplasjes me automjetin A ka qenë rreth 106 km/h, ndërsa automjeti A-Mercedes (bazuar në videoinqizimin) shihet se në sekondën e fundit para goditjes i njëjti ndalet tërësisht afër vijës së mesit të rrugës, me tutje ka theksuar se arsyeja e ndaljes së shoferit të automjetit A në sekondën e fundit para goditjes ka mundur të jetë si pasojë e reagimit jo-adekuat të shoferit të automjetit A (Mercedes në momentin që i njëjti e vëren rrezikun në rrugë (ardhjen me shpejtësi të madhe nga krahu i tij i majtë i automjetit B-Audi), apo ndonjë rrethane tjetër e cila nuk mund të përcaktohet përmes kësaj ekspertize, deri tek ky aksident ka theksuar se nuk do të vinte po qe së shoferi i automjetit “A” në momentin para arritjes në udhëkryq të ndaljes para shenjës STOP, ndërsa kyçje me automjet në rrugën kryesore ta bëjnë me një kujdes të shtuar duke verifikuar më parë prezencën e mjeteve në rrugën në të cilën po kyçej – duke mos rrezikuar veten dhe pjesëmarrësit tjetër në komunikacion respektivisht shoferin me automjetin B i cili atij i vinte nga krahu i tij i majtë dhe të cilin ka mundur ta vërej me ndihmën e tufës së dritave për ndriçimin e rrugës, dhe ky aksident do të mund të evitohet edhe po qe se shoferi me automjetin B (Audi) shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të tij t’ia përshtaste kushteve të rrugës, poqese i njëjti do të lëvizte brenda kufizimit të shpejtësisë së lejuar për atë pjesë të rrugës (50km/h) me rast i njëjti me frenim të vullshëm në automjet do të mund të ndalej në mënyrë të sigurt pa u godit fare me automjetin A (Mercedes). Distanca e dukshmërisë vertikale në rrugë (nga momenti kur shoferi i automjetit B ka patur mundësi ta vërej prezencën e automjetit A në rrugë) ka qenë më tepër se 45 metra, distancë kjo e nevojshme që shoferi i automjetit B do të mund ta ndalte automjetin e tij para pikës së kontaktit me ngadalësim mesatar (pa patur nevojë të frenojë vullshëm në automjet) poqese i njëjti do të reagonte në kohë dhe do të lëvizte brenda kufizimit të lejuar të shpejtësisë për atë pjesë të rrugës. Eksperti ka konstatuar se rruga e ndaljes së automjetit B (për shpejtësinë e kufizuar prej 50km/h me frenim të vullshëm do të ishte jo më shumë se 27 metra duke i analizuar të gjitha rrethanat e lartcekura eksperti ka konstatuar se ky aksident i komunikacionit rrugor është shkaktuar si pasojë e lëshimeve të dy shofereve të automjeteve A dhe B me veprimet e tyre, shoferi i automjetit A (mercedes) kyçje e pasigurt me automjet nga rruga dytësore në rrugë kryesore – duke mos u ndalur fare para shenjës STOP me rastin e hyrjes në udhëkryq- duke mos respektuar përparësinë e kalimit të automjetit B i cili lëvizte në rrugë Kryesore, Shoferi i automjetit B (Audi) mos përshtatje e shpejtësisë së lëvizjes në raport me kushtet e rrugës duke lëviz me shpejtësi jashtë- normave të lejuar për atë pjesë të rrugës (mbi 10km/h në vendin ku kufizimi ka qenë 50 km/h nën kushtet e dukshmërisë së zvogëluar në rrugë.

Gjykata gjithashtu ka pranuar edhe ekspertizën nga lemia e aktuaristikës dhe financave të ekspertit A.B.i cili ka pasur për detyrë të bëjë llogaritjen e mbajtjes së humbur të familjes së të ndjerit D.F.nga Ferizaj, si pasojë e vdekjes së tij në aksidentin e trafikut të datës 15.07.2018 dhe atë për periudhën e kaluar prej ditës së aksidentit-vdekjes së tij me dt.15.07.2018 e deri me dt. 30.06.2020 kur ka konsideruar si date të kryerjes se kësaj ekspertize dhe për periudhën e ardhshme prej 01.07.2020 e tutje sa për këtë ekzistojnë kushtet ligjore, në dy mënyra në forme të pagës mujore dhe në forme të të pagesës së menjëhershme – të kapitalizuar. Konstatimi i ekspertit i cili ka konstatuar se tani i ndjeri D.F.ka lindur me dt. 20.05.1975, në aksidentin e trafikut të datës 15.07.2018 ka pësuar lëndime të renda trupore si pasojë e të cilave ka vdekur në të njëjtën dite, ai pas vete ka lënë këta anëtare të familjes së tij të ngushtë- bashkëshorten L. F.n, e lindur me datë 11.07.1976(e pa punë, djalin J. F.n, i lindur me 22.07.2008- nxënës në kolegjin privatnë Ferizaj dhe nënën K.F., e lindur me 28.09.1948 në pension bazik të pleqërisë me të cilët ka jetuar edhe për mbajtjen e të cilave ka kontribuar deri në momentin e vdekjes. D.F. para se të vdiste, prej vitit 2009 e deri me 30.12.2018 ka qenë i punësuar tek punëdhënësiLTD në Afganistan me pagë prej nga 5,000€ siç shifët nga pasqyra bankare mbi pagat e realizuara të tij.

Me 15.10.2018 familja e tij e dëmtuar ushtron kërkesë padi në këtë gjykate me c rast përpos llojeve tjera të demit kërkon dhe kompensim të demit material të formës së mbajtjes së humbur-rentës prej nga 5000€ në muaj. Duke filluar prej ditës se aksidentit e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore me kamatë prej 12% në vit prej ditës se ushtrimit të padisë e deri në ditën e pagesës definitive.

E veja L. F. asnjëherë nuk ka qenë dhe as që është në marrëdhënie pune siç shifët edhe nga Pasqyra e trustit të saj pa kontribute se e njëjta pra L. F. me familje nuk është përfituese e ndihmës sociale nga Qendra për Pune sociale në Ferizaj siç shifet nga vërtetimi nr.48 i datës 21.01.2019.

Gjate punës në Afganistan tani i ndjeri D.F.pagën e realizuar në dollar Amerikan dhe përpos kësaj për çdo 6 muaj atij i është lejuar vizita në familjen e tij në Kosove-Ferizaj për çka dhe i janë kompensuar nga punëdhënësi shpenzimet e udhëtimit vajtje ardhje Avganistan-Kosovë dhe anasjelltas.

Paga e fundit që ka realizuar tani i ndjeri në Avganistan është ajo me 22.05.2017 pra 14 muaj para se të vdiste të cilat i ka terhequr vet nga banka në Kosove, ndërsa para kësaj date i kishte tërhequr bashkëshortja e tij- tani paditësja L. F.. I ndjeri D.F.dhe para se të punësohej në Avganistan kishte qenë i punësuar në kampin- në Kosovë, ku puna e tij ishte vlerësuar lartë. Ndërsa para se të shkoje ne Avganistan kishte qenë i punësuar dhe në NT-

.....” në Ferizaj, i renditur në punët e menaxherit me pagë prej nga 350 € në muaj dhe me shtesë prej 20% për orë pune jashtë orarit, e cila shifet nga kontrata e punës në shkresat e lëndës.

Të vetmin fëmi që e kishte D.F., djalin J. F.n që vitin 2014 e kishte regjistruar në vitin e parë të shkollimit në kolegjin privatnë Ferizaj me kosto vjetore të shkollimit aty prej nga 1700€ ku tani viJ. F.vitin e gjashtë me sukses shumë të mire, siç shihet nga kontrata e regjistrimit dhe nga vërtetimi i suksesit të reguar në mësim.

Pasi që periudhën me të gjatë se 12 muaj para vdekjes akidentale i ndjeri D.F.ishte pushuar nga puna në Avganistan, bazuar ne rregulloren BQK-se, nga pamundësia që me rastin e llogaritjes së mbajtjes se humbur tani të paditësve të marre për bazë pagën që D.F. e kishte realizuar në Avganistan prej nga 5000€ në muaj, që u përcaktuar që me këtë rast ta marrim për bazë pagën prej 350€ në muaj që ai kishte realizuar në N.T në Ferizaj para shkuarjes së tij në Avganistan.

Pasi që të vetmin fëmijë që kishte tani i ndjeri Driton së bashku me bashkëshorten e tij L. F.n e kishin regjistruar për shkollim në kolegjinnë Ferizaj e me kosto të shkollimit prej nga 1700 në vit gjegjësisht 141.70€ në muaj, me rastin e llogaritjes së mbajtjes së humbur të paditësve L. F. e J. F.(por jo edhe nënës së tij se D.Q.pasi që ajo është përfituese e pensionit të pleqërisë) fillimisht nga paga e besueshme e D.F.t prej 350€ në muaj ndamë për shkollimin e Djalit J. F.t 141.66€, ndërsa me mbetjen prej $209.30/3=69.55€$, pra për veshmbathje D.F. do të shërbente 69.45€ të cilën shumë kur të zbresim nga paga e tij e besueshme prej nga 350€ në muaj.

Definitivisht fitohet renta mujore për të vënë L. F. dhe Djalin e saj J. F.n prej nga $350-69.44=280.55€$ dhe atë nga 69.45€ për vetëm vajtje+ për shkollim $141.66=211.11€$ për J. F.n dhe nga 69,47€ për të vënë L. F.n.

Për tërë periudhën e kaluar prej aksidentit-vdekjes së mbajtësit D.F.me 15.07.2018 e deri më tani 30.06.2020 eksperti ka konstatuar kur e konsideron si datë të kryerjes së kësaj ekspertize, mbajtja e humbur-renta e arritur për pagese arrijnë shumë prej 6,604€ që së bashku me kamate të llogaritur sipas arritjeve mujore për pagese e norme prej 8% në vit prej ditës së ushtrimit të padisë me 15.10.2018 e deri me tani 30.06.2020, prej 490€ arrin gjithsejtë 7,094€.

Për periudhën e ardhshme prej 1.07.2020 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore ka konstatuar se renta mujore arrin në 280.55€ apo për J. F.n nga 211.10€, për L. F.n nga 69.45€ me tutje në ekspertize ka konstatuar se nëse arrihet pajtimi në mes palëve që për periudhën e ardhme kjo rentë mujore të paguhet në formë të menjëhershme- të kapitalizuar atëherë duke aplikuar tabelat e mortalitetit të banorëve femra përkatësisht meshkuj të aplikushme nga BQK-

ja në Kosove dhe kamatën diskonte prej 3% në vit, del se shuma e saj e kapitalizuar arrijnë në : a) për periudhën prej 01.07.2020 e deri me 22.07.2026 kur paditësit J. F. do të i mbushte 18 vjet shumën prej $211.10 \cdot (N12 - N18) / D12 = 2,533.20 \cdot 5.58 = 14,135.25\text{€}$

Për L. F.n $69.45 \cdot 12 \cdot (N44 - N50) / D44 = 833.40 \cdot 5.56 = 833.40 \cdot 5.56 = 4,633.70$.

Gjithsejtë : $14,135.25 + 4,633.70 = 18,768.95\text{€}$.

Mendimi dhe konstatimi i ekspertit A.B.i cili në ekspertizën e dorëzuar me shkrim ka konstatuar se familjes së dëmtuar të ndjerit D.F., gjegjësisht vetëm të vejes dhe djali të tij – tani paditësve L. F. përkatësisht J. F. (por jo edhe nënës së tij Keseres si përfituese e pensionit të pleqërisë që është) nga Ferizaj, si pasojë e vdekjes se tij, pra D.F.t në aksidentin e trafikut të datës 15.07.2018, përpos lloje të tjera të demit iu takon e drejta edhe në kompensimin e demit material të formës së mbajtjes së humbur e cila arrin në vlerë prej:

a) për periudhën e kaluar prej akcidentit-vdekjes së D.F.me 15.07.2018 e deri më tani 30.06.2020 ku ka konsideruar si datë të kryerjes së kësaj ekspertize në shumë prej 6,604€ që së bashku me kamate të llogaritur më normë prej 8% e sipas arritjeve mujore për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë me 15.10.2020 e deri me tani 30.06.2020 prej 676€, gjithsejte bëjnë 8.777€, ndërsa b) për periudhën e ardhshme prej 01.07.2020 e tutje deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumë mujore prej 313.89€ cila e paguar në forme të menjëhershme – të kapitalizuar arrin në 47,267.73€, shuma e gjithmbarshme rentës për periudhën e kaluar së bashku me kamate dhe për periudhën e ardhme e paguar në formë të menjëhershme –të kapitalizuar arrin vlerën prej $8,101 + 676 + 47,276.73 = 56,053.73\text{€}$.

Se paditësit në këtë aksident kanë përjetuar dhimbje shpirtërore, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të psikiatrisë Dr. Sh.H.- Psikiatër, i cili ka ardhur në përfundim se D. F. ishte biri i vetëm i K.F., bashkëshorti i L. F.dhe Babai i J. F.. i cili humbi jetën në aksidentin e trafikut me datën 15.07.2018, D. F. ishte një burrë me shëndet të plotë, person i gëzueshëm dhe i hareshëm jashtëzakonisht pozitiv, bashkëpunues dhe prind i shkëlqyeshëm, roli i tij në familje ka qenë unifikues-bashkues si dhe ka mbështetur të gjithë anëtarët e familjes në problemet dhe sfidat e tyre jetësore. Vlerësimi i dhimbjeve shpirtërore për anëtarët e Familjes dhe atë K.F.e lindur me 28.09.1948 në Ferizaj, penzionere, njeherit nëna e të ndjerit D. F. me të kuptuar lajmin e kobshëm për aksidentin e djalit të vete tek e njëjta janë shfaqur menjëherë ligështim, shqetësim si dhe dhimbje shpirtërore e cila është manifestuar me mërzi, me ndjenjën e humbjes së madhe të pa kompensueshme të djalit të saj, ajo kishte rënë në depresion, ankth dhe nuk kishte pas gëzime as në lumturi, me ka vdekur djali im i vetëm/ fjalët e saj në vazhdim, nuk kishte pas vullnet as për të jetuar e as për të u përkujdesur për veten e saj.

Të gjitha këto shqetësime dhe ndryshime në jetën e saj shpirtërore vlerëson si dhimbje shpirtërore e cila ka kaluar nëpër faza apo etapa dhe atë: dhimbje e Intenzitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 muaj, dhimbje e intenzitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 1 viti, dhimbje e intenzitetit të ulët është ende prezentë sidomos në përvjetorët e vdekjes si dhe në festat e ndryshme familjare ose religjioze.

L. F., bashkëshortja e D. F. e lindur me 11.07.1976 në Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme drejtimin gjuhësor, e vejë, nënë e një djali, aktualisht e pa pune, zonja ishte me djalin në gjumë kur morri lajmin se bashkëshorti është aksidentuar por jo edhe lajmin e kobshëm. Pasi që kishte arritur në Q.E në Prishtinë, ka taktuar të vëllain që ishte me bashkëshortin e saj në veturë por jo edhe burrin e saj, ka pritur diku rreth dy orë duke i dhënë informata të ndryshme pasi ka kuptuar se bashkëshorti i saj me nuk do të paraqiste as nga salla operative e as në spitalin e Ferizajt etj.

E njëjta ka përjetuar dhimbje shpirtërore e cila është manifestuar me mërzitje, me ndjenjën e pakompensushme të humbjes së bashkëshortit, një lloje zbrapseje emocionale, ka pasur reaksione depresive me ankthe natën, pagjumësi dhe humbje të vullnetit për jetë, për pune është konsultuar edhe me psikiatër, e njëjta me shumë vështirësi emocionale ka kaluar periudhën e adaptimit edhe sot gjatë ekzaminimit psikik ka ringjallë emosioneve shpërthyesë tre vajit dhe njënjë të zbrazësisë për të cilat duhet bërë edhe ndërprerje të intervistës. Të gjitha këto shqetësime ndryshime në jetën e saj shpirtërore vlerëson si dhimbje shpirtërore e cila ka kaluar nëpër faza apo etapa : dhimbje e Intenzitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 muaj, dhimbje e intenzitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 1 vite; dhimbje e intenzitetit të ulët është ende prezentë sidomos në përvjetorët e vdekjes si dhe në festat e ndryshme familjare ose religjioze.

J. F., fëmiju i vetëm i D. F. i lindur me 22.07.2008 në Gjilan, nxënës i shkollës fillore, J. F. kishte qenë së bashku me nënën në shtëpi kur gruaja e dajës i ka kontaktuar në telefon për të i lajmëruar për rastin por nuk e ka ditur se çka ka ndodhur, pohon se nëna i ka treguar të nesërmen, fillimisht nuk e ka kuptuar se çka në të vërtetë ka ndodhur por se nëna e tij është munduar që të i shpjegoj dhe pastaj pas varrimit ka kuptuar se do të jetë vetëm, dhe nuk ka kush me mbrojtë se babain nuk do ta këtë më pranë ishin fjalët e tij. Ka pasur shqetësime natën, ka fjetur me dritë të ndezur, ka humbur interesimin dhe angazhimin për mësim, vullnet të ulur dhe qasje ndryshe. Të gjitha këto shqetësime ndryshime në jetën e tij shpirtërore vlerësohen si dhimbje shpirtërore i cili ka kaluar nëpër faza apo etapa dhe atë: dhimbje e Intenzitetit të lartë në kohëzgjatje prej edhe dy muajve, dhimbje e intenzitetit të mesëm në kohëzgjatje prej edhe dy muajve të vijues, dhimbje e intenzitetit të ulët në kohëzgjatje prej edhe dy muajve të tjerë vijues.

Nga ana e gjykatës e me propozimin e të autorizuarit të paditëses është nxjerr prova me ekspertizë financiare nga eksperti A.G., i cili në mendimin dhe konstatimin e tij ka konstatuar se paditësit kanë pësuar dëm material nga aksidenti që ka ndodhur me datë 15.07.2018 në të cilin aksident ka humbur jetën D. F., përveç kompensimeve tjera jo materiale dhe materiale, sa i përket kompensimit për rentë mbajtjen e humbur, eksperti ka deklaruar se mbajtja e humbur – renta për periudhën e kaluar prej ditës së aksidentit me datë 15.07.2018 deri me datën 30.11.2020 i takon gjithsejtë shuma prej 133,041.88 euro dhe kamat vjetore në shkallë prej 8% prej ditës ë ngritjes së padisë me datë 15.10.2018 deri me datë 30.11.2020 është 1,214.23 euro, pra gjithsejtë shuma prej 14,256.11 euro.

Për periudhën e ardhshme prej 01.12.2020 deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, paditëses L. F. me të birin J. F.n në emër të mbajtjes së humbur- rentës i është llogaritur kompensimi mujor në lartësi prej 448,56 euro.

Gjykata ekspertizat e punuara dhe atë në mendimin e ekspertizës së ekspertit V.B. të dorëzuar me shkrim, ekspertit të komunikacionit B.K., mendimit dhe konstatimit të ekspertëve A.B.nga lëmit e sigurimeve, aktuaristikës dhe financave, mendimit dhe konstatimit të ekspertëve A.G. nga lëmit e sigurimeve, aktuaristikës dhe financave si dhe mendimi dhe konstatimit të psikiatër Dr.Sh.H., si dhe ekspertiza e ekspertët për vlerësim të demit në automjet të ekspertit Q.A., të cilave ekspertiza gjykata ia ka falur besimin në tërësi si ekspertiza të plota, profesionale dhe objektive.

Nga vërtetimi i papunësisë i datës 07.09.2020 i lëshuar nga Agjencia e punësimit e Republikës së Kosovës është vërtetuar fakti se L. F.është e papunë.

Gjykata lidhur me lartësinë e demit material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 të LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 137,159, 169, 173, dhe 961 të LMD-së, ekspertizës së makinerisë si dhe dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova në këtë çështje juridike.

Kurse sa i përket fitimit të humbur-rentën mujore gjykata ka vlerësuar është në kundërshtim me nenin 137.1 të LMD-së, gjykata konsideron se duke u bazuar në këtë dispozitat ku thuhet “ *I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e demit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur*”, si dhe dispozitës 137 par.3 të LMD-së, e cila përcakton “*Gjatë vlerësimit*

të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin”, andaj si rezultat i këtij aksidenti paditësit si rezultat i këtij aksidenti kanë përjetuar humbje të anëtarit të familjes së tij, do të thotë se po të mos ekzistonte ky aksident respektivisht do të kishin bashkëshortin dhe babin i cili do të kishte mundësi të punonte dhe do të realizonte të ardhura, dhe të siguronte mirëqenien dhe jetesën e paditësve.

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësit si pasojë e aksidentit të cekur më lart, kanë pësuar dëm material dhe jo material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjëseve respektivisht në mbështetje të nenit 19 të LSDA-së, si dhe duke u bazuar në nenin 136, nenin 173 par.1, 179 dhe nenin 183 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësve në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën prej 8% pasi që me Ligjin mbi marrëdhëniet e Detyrimeve në kuptim të detyrimit që rrjedh nga dëmi i shkaktuar si dhe kamatën lidhur me këtë rast e llogariti nga data 15.10.2018 prej datës kur është bërë ekspertiza mjekësore dhe gjykata është bindur se ekziston dëmi i tillë, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e miratuar në dispozitivin II, pasi që shumat e kërkuara si në precizimin e kërkesëpadisë ishin shuma tepër të larta e të cilat nuk përkojnë me asnjë praktikë gjyqësore, e tërë kjo duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të mjekësisë si dhe krahasimin e praktikave gjyqësore lidhur me lëndimet dhe pasojat e ngjashme të këtij karakteri, e duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumat e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e theksuar nga paditësi për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të t'paditurës, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj mbi shumën e ofruar, pasi që shumat e kërkuara si në padi janë shumë të larta dhe se nuk përkojnë as me kriteret e kompanive të sigurimit e as me praktikën gjyqësore në lidhje me lartësinë e kompensimit për raste të tilla apo të ngjashme, këto

theksime gjykata pjesërisht i morri si të bazuara e të cilat kishin të bënin lidhur me lartësinë e shumës së kompensimit, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 6,008.40 € dhe atë: 416€ për përpilimin e padisë (pasi kemi të bëjmë me 3 paditës), 416€ për parashtresën për precizim të padisë, për 8 (tetë) seanca të mbajtura shumë prej 4,326.40 €, 150€ për ekspertizën e komunikacionit, 150€ për ekspertizën e makinerisë 150€, për ekspertizën e psikiatrisë, për ekspertizës financiare të punuar nga A.B.shumën prej 250,00€, dhe për taksë gjyqësore shumë prej 100,00€, pasi kemi të bëjmë me 3 paditës dhe vlera e kontestit e kalon shumë prej 10,000 euro.

Ndërsa gjykata e ka refuzuar pagesës e ekspertizës së financiare nga eksperti A.G..pasi ka qenë propozim i paditësve, dhe se ka qenë një ekspertizë me parë e punuar.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM

C.nr.991/18 prej datë 4 mars 2021

Gjyqtarja:

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.